



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORE
NJËSIA E PROKURIMIT

Nr. _____ Prot.

Vlorë, më _____._____.2026

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës – Mallra , e hapur e thjeshtuar

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

**OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje shtypshkrime & kancelari, leter printeri për vitin
2026 per autoritetin kontraktore Bashkia Vlore**

1. Lloji i procedurës së prokurimit të jetë **Mareveshje Kuader me nje operator ekonomik
ku te gjitha kushtet jane te percaktuara -me afat (12 muaj) .**

Lloji i procedurës së prokurimit të jetë: **Procedurë e Hapur e Thjeshtuar Malla**

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT(FPP)

Kodi CPV: 30197643-5 - Letër fotokopjuese, 79800000-2 - Printime dhe shërbime të lidhura, 30194500-0 - Mjete ndihmëse për letrat,

VLERA E FONDIT LIMIT I KONTRATËS: 3,899,982 lekë (tremilion e teteqind e nentedhjete e nente mije e nenteqind e tetedhjete e dy) Lekë pa TVSH ku janë përfshirë nevojat e autoriteteve kontraktore përfituese, si më poshtë:

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” (të ndryshuar) nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), Autoriteti / Enti Kontraktor, Bashkia Vlore n, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenet 76 dhe 82 të LPP Nr. 162 datë 23.12.2020, si dhe nenin 26 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", me ndryshime, ku mes të tjerave citohet se: "...Autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të LPP. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik..."

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

Argumentimi: Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 "Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit" dhe Neni 83 "Sigurimi i ofertes", të Ligjit Nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik" si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: citojme Neni 83 i LPP "Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël", Neni 82, i LPP "1. Bashke me dorezimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prove paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik".

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën, duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2022, 2023, 2024), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 30 % e vlerës së fondit limit të objektit që prokurohet**. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 76 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" të ndryshuar dhe nenit 25 të VKM-se nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" të ndryshuar.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit **nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës**, në vlerën **jo më pak se 20% e vlerës së fondit limit të objektit që prokurohet**. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës dhe / ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- c. **Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenin 43 pika 2/c dhe nenin 55 pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “ Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomik ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomike dhe financiare për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.
- d.
- e. Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit është brenda kufirit të përcaktuar në nenin 43 pika 2/c të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, ku përcaktohet se c) 40 % të vlerës së përlogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në kontratat e shërbimit me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posacme.”
- f. Referuar sa më sipër duke qënë se vlera e fondit limit është në kufirin e vlerës që i përket llojit të procedurës “Procedurë e hapur të thjeshtuar” edhe vlera e kërkuar për xhiron do të vendoset konform kësaj procedure prokurimi sipas përcaktimit të bërë në nenin 43 pika 2 (c) e VKM Nr 285 dt 19.05.2021 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar).

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë certifikatën **ISO 9001:2015 “Mbi Sistemet e Menaxhimit të Cilësisë”** / ose ekuivalent (të vlefshme në datën e zhvillimit të tenderit), në përputhje me objektin e prokurimit, të lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi: Këto kriteret janë vendosur në përputhje me nenin 79 “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, në të cilin gjejmë të përcaktuar se: 1. “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatatë lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit. Ky kriter gjen mbështetje në pikën 1 të nenit 44 “Kërkesat e cilësisë “të VKM nr.285 date 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” ku përcaktohet se: 1. “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose

shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organisma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit". Sa më sipër, ky kriter shërben për njohjen e kapacitetit të operatorëve ekonomikë ofertues dhe aftësinë e tyre teknike dhe profesionale për të furnizuar artikuj cilësorë dhe që janë prodhuar / vendosur në treg sipas standardit të sipërpërmendur. ISO 9001 përcakton kërkesat për një sistem menaxherial të cilësisë dhe mund të implementohet dhe të certifikohet nga çdo shoqëri, pavarësisht dimensioneve apo fushës së aktivitetit. (e nevojshme për objektin e prokurimit, të cilin AK kërkon të kryhet me cilësi dhe në kohë). Duke parë objektin e prokurimit, autoriteti kontraktor vlerëson të nevojshme të kërkojë që operatorët ekonomikë ofertues të jenë të pajisur me certifikata të cilësisë në përputhje me objektin e prokurimit, me qëllim që furnizimet të kryhen me cilësi sipas certifikatës ISO të mësipërme.

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqesë një **deklaratë**, me anë të së cilës merr përsipër të kryejë **shërbimin e transportit** të artikujve objekt prokurimi në adresën e autoritetit kontraktor përfitues.

SHTYPSHKRIME

Regjister korespondence A3 x 300 fl
Libri I sekretarise A3 x 200 fl
Liber poste A4 x 200 fl
Lidhje regjistrash Keshilli Bashkiak
Liber magazine 500 flete lekure
Liber llogarie
Ditar arke I madh
Blllok flete dalje
Blllok flete hyrje
Mandat arketimi
Mandat pagese
Listeprezence e madhe
Liber page
Ditar magazine I madh partitar
Libreze e taksave Bujqesore, me ngjyra, karton kolor
Regjister korespondence A3 x 100 fl
Buxheti libra
Akt kontrolli tatim taksat
Liber Vleresimi tatimor per subjektet
Regjistri I arketimeve
Tatim taksat Liber kod vendor

Regjister korespondence A3
Liber sherbimi 200 flete P/Bashkiake
Fature per arketim
Bileta tregu Q/Adm. Novosele
Regjister indeks paftesie
Vertetim Rajoni 100
Vertetim Rajoni 500
Akt kontrolli P/Bashkiake

Sqarim: Per artikujt e shtypshkrimeve te cilat jane regjistra, libra etj qe do te prodhohen ne shtypshkronje operatorët ekonomik kur te depozitohet dokumentacioni tekniko ligjor do te pajisen me secilen flet perkatese te cilat do te prodhohen.

Argumentimi: Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4; në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Kreu V, Seksioni III, 40, pika 8.

Qëllimi i vendosjes së këtij kushti është i implementuar sipas dispozitave ligjore dhe shërben si një garanci që kontrata objekt prokurimi do të realizohet me sukses sipas Specifikimeve Teknike (të cilat do publikohen së bashku me Dokumentat e Tenderit) si dhe zërave të preventivit objekt i kontratës.

2.3.4 2.3. Operatori ekonomik duhet te paraqese mostra të mallit ditën dhe orën e hapjes se tenderit , sepse Autoriteti Kontraktor e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Mostrat do të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe do të jenë në kontroll të autoritetit kontraktor. Dorëzimi i Kampioneve/ mostrave të bëhet Bashkise Vlorë, të etiketuara me ngjithëse , të vulosur/a, mbi të cilin/at të shënohet: “Mos e hapni me përjashtim te rasteve kur është i pranishëm Komisioni i Vlerësimit te Ofertave të kësaj procedure prokurimi ”

-Së bashku me mostrat ofertuesi duhet të japë edhe një shkresë të vulosur dhe firmosur ku të listohen mostrat që ndodhen të paketuara.

Lista e produkteve mbi bazën e së cilës O/E duhet të dorëzojnë mostrat,në ditën dhe orën e caktuar në DST;

Nr	Emërtimi
1	Blllok flete dalje
2	Blllok flete hyrje
3	Mandat arketimi
4	Mandat pagese
5	Leter fotokopje 80 gr /m2,A4
6	Blllok lekure shenimi A4 x 120 fl

7	Stilolaps cilesor per lidhje marreveshje
8	Dosje kuti mekanizem, lekure 7 cm i, gold me kuti te zeze
9	Evidenciator me ngjyra te ndryshme minimumi 4.5mm
10	Korrektor stilol blister
11	Dosje kartoni me karton cilesor 300 gr. m2,
12	Makine qepese aktesh 220 flete
13	Dosje me llastik te gjere 4 cm
14	Dosje me Buton nr. 15 plastike,
15	Kalkulator 12 digit
16	Makine heqese teli flutur
17	White Markers per derrase te zeze

Argumentimi: Specifikimet teknike janë hartuar nga autoritetet kontraktore përfituese për objektin që prokurohet sipas nevojës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP i ndryshuar, si dhe nenit 40, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, dokumentuar me relacionet / procesverbalet përkatëse të mbajtura, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Për Hartimin e Specifikimeve Teknike dhe Përlllogaritjen e Fondit Limit të Tenderit” Shtypshkrime, kancelari dhe letër printeri.

Në zbatim të Ligjit Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, si dhe në ushtrim të funksioneve normale dhe të pandërprera të Bashkisë Vlorë për garantimin e mirëfunksionimit të drejtorive, Njësi Administrative, në varësi të saj, IA-ve dhe Këshillit Bashkiak lind nevoja për sigurimin e vazhdueshëm të shtypshkrimeve, kancelarive dhe letër printeri. të domosdoshme pasi përbëjnë një komponent thelbësor në realizimin e objektivave për orientimin, shërbimin dhe lehtësimin që ndihmojnë në përgatitjen e dokumentacionit administrativ.

Duke qenë se këto nevoja janë të karakterit periodik dhe të përsëritur gjatë vitit buxhetor, si dhe nuk mund të parashikohen saktësisht në kohë dhe sasi për çdo institucion individualisht në formën e **Marrëveshjes Kuadër**, në përputhje me nenin 35, neni 36, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 12, neni 13.

Procedura e prokurimit zhvillohet në zbatim të:

- Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”;
- VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”;
- Urdhrit të Kryetarit të Bashkisë Vlorë nr. 46, datë 20.01.2026;
- Buxhetit të miratuar për vitin ushtrimor përkatës.

Artikujt objekt prokurimi janë të nevojshëm për:

- zëvendësimin e materialeve dhe shtypshkrimeve, kancelarive dhe letër printer të amortizuara, të dëmtuara ose jashtë funksionit;
- furnizimin e vazhdueshëm me materiale konsumatore si:(regjistër korespondence, ditar magazine, bllok fletëhyrje, letër printeri A3, A4, lapsa, stilolapsa, kapse, dosje) të cilat përdoren çdo ditë dhe konsumohen;
- mirëmbajtjen dhe realizimin e saktë të dokumentacionit administrativ;
- mbështesim funksionimin e zyrave për administrim, arkivim dhe komunikim.

Mosrealizimi i kësaj procedure do të cënonte funksionimin normal të punës administrative dhe arkivore.

Specifikimet teknike janë hartuar mbi bazën e “Operatorit të Blerjeve të Përqendruara (OBP) sh.a.i cili standardizon/unifikon specifikimet teknike/cmimet për mallra dhe/ose për shërbime që prokurohen në mënyrën të përqendruar, në përputhje me standardet e miratuara, në bashkëpunim me specialistët e fushave të institucioneve përgjegjëse ose specialistë të jashtëm, vendas apo të huaj, dhe harton katalogët e standardeve. Katalogët e standardeve janë orientues dhe rekomandues për autoritetet/entet kontraktore....” si dhe në zbatim të gërmës “c”, të pikës 11, të VKM-së Nr.531 datë 07.09.2023 ka hartuar katalogun me specifikimet teknike dhe çmimet e unifikuara për objektin e prokurimit: “Blerje materialesh kancelarie”.

Grupi i punës i është drejtuar me shkresë cdo drejtorie, rajoni dhe Njësive Administrative në Bashkinë Vlorë, Këshillit Bashkiak me shkresë me nr.prot. 1686 datë 26.01.2026 si dhe IA-ve e çerdheve nën juridiksionin e Bashkisë Vlorë me postë elektronike në datë 26.01.2026 (bashkëlidhja 1)

Preventivi dhe fondi limit janë përlogaritur mbi nevojat reale të institucioneve ardhur me shkresat zyrtare. (bashkëlidhja 2)

Ky relacion shërben si bazë për nisjen e procedurës së prokurimit “Marrëveshje Kuadër për blerjen e shtypshkrimeve, kancelarive dhe letër printeri”, me qëllim argumentimin ligjor, teknik dhe ekonomik të realizimit të saj, si dhe dokumentimin e procesit të ndjekur nga grupi i punës për përcaktimin e nevojave, hartimin e specifikimeve teknike dhe përlogaritjen e preventivit.

Dokumentacioni i hartuar garanton zhvillimin korrekt të procedurës dhe përdorimin efikas, transparent dhe të përgjegjshëm të fondeve publike.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

